

AKT THEMELIMI
i shoqërisë "Italian Glam" Sh.p.k.

Sot, me datë 25/05/2020,

- **Z. Bujar Doku**, shtetas shqiptar, atësia Sabri, lindur në Sanxhak Laç, më 07/11/1971, banues në Rruga "Buna", Vilë 3- katëshe, Tiranë, e mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. H11107030A, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Qendra Vizion Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në: Rruga "Teodor Keko", Njësia Tregtare Nr. 712, Shkalla 3, Kati i I-rë, Zona kadastrale 3866, Tiranë, Shqipëri, me NUIS L52116135J, përfaqësuar nga Administratori Znj. Gordana Belba, shtetase shqiptare, lindur më 02/09/1978, në Durrës, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal H85902037B, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Italian Glam" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Italian Glam" Sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Godinë 1- katëshe, përballë pallatit Nr. 29, ZK 4863, Tiranë, Shqipëri.
Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Import - eksport, tregti me shumicë dhe/ose pakicë si: veshje, çanta, këpucë, aksesore të ndryshëm.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 3.000.000 Lekë (tre milion) dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Bujar Doku**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.500.000 (një milion e pesëqindmijë) Lekë dhe 1.500.000 (një milion e pesëqindmijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Qendra Vizion Sh.p.k.**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.500.000 (një milion e dyqind mijë) Lekë dhe 1.500.000 (një milion e pesëqindmijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Bujar Doku**, shtetas shqiptar, lindur më 07/11/1971, në Sanxhak, Laç, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal H11107030A, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Bujar Doku** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

BUJAR DOKU



Qendra Vizion Sh.p.k.

**Përfaqësuar nga
GORDANA BELBA**

